



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 1239/2 Prot.

Tiranë, më 09 . 07 . 2026

V E N D I M

Nr. 189, Datë 09 . 07 . 2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 161, datë 30.06.2026 e paraqitur nga z. N.P kundër Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Fier sh.a, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “moshës¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Subjekti ankues në formularin e ankesës ka parashtruar se: “*Matësi i ujit në banesë ka qenë i amortizuar dhe i dëmtuar si pasojë e përdorimit normal ndër vite. Për këtë arsye kam kërkuar pranë UK Fier zëvendësimin e tij. Megjithatë kërkesa është paraqitur prej kohësh, ndërrimi i matësit është kryer pas rreth një viti. Pas zëvendësimit më është ngarkuar një tarifë pagese (625 lekë) për matësin e ri, me të cilin nuk jam dakord. Unë jam pensionist dhe kam dijeni se pensionistët përjashtohen nga pagesa e kësaj tarife në rastë të tilla. Theksoj se dëmtimi i matësit nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë veprimi me dashje, neglizhencë apo keqpërdorim nga ana ime, por si pasojë e amortizimit nga përdorimi. Për këtë arsye kërkoj që kostoja e zëvendësimit të matësit të mbulohet nga UK Fier”.*

Subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe rregullimin e pasojave.

¹ Referuar Certifikatës familjare datë 03.10.2025, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile 153 e Bashkisë Fier, rezulton se ankuesi ka lindur në datë 01.04.1952.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga kuptimi i dispozitave të sipërcituara rezulton se, për të pasur një pretendim të pranueshëm për diskriminim, nuk mjafton vetëm ekzistenca e një pakënaqësie ndaj një veprimi administrativ, tarife, vendimmarrjeje apo mënyre zbatimi të një detyrimi financiar. Duhet të rezultojnë, të paktën në nivel paraprak, fakte konkrete që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se ankuesi është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme se persona të tjerë në situatë të njëjtë ose të ngjashme dhe se ky trajtim ka ardhur për shkak të një karakteristike të mbrojtur nga ligji, në rastin konkret për shkak të moshës.

Nga dokumentacioni i administruar rezulton se ankesa e z. P lidhet me kundërshtimin e pagesës së kërkuar për zëvendësimin e matësit të ujit. Pretendimi kryesor i ankuesit është se ai, për shkak se është pensionist, duhet të përfitojë përjashtim nga pagesa e matësit. Në këtë kuptim, pretendimi i tij lidhet me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të rregullave për tarifimin apo subvencionimin e matësve të ujit, më shumë sesa me një trajtim të diferencuar për shkak të moshës.

Në rastin konkret, nga ankesa nuk rezulton që z. P të ketë paraqitur fakte krahasuese lidhur me abonentë të tjerë të Shoqërisë Ujës-jellës Kanalizime Fier sh.a., të cilët, në kushte të njëjta ose të ngjashme, janë përjashtuar nga pagesa e zëvendësimit të matësit. Gjithashtu, nuk rezulton që ankuesi të ketë paraqitur të dhëna që tregojnë se pagesa i është vendosur për shkak të moshës së tij, apo se Shoqëria Ujës-jellës Kanalizime Fier sh.a. ka zbatuar një praktikë të veçantë, përjashtuese ose më pak të favorshme ndaj tij si person i moshuar/pensionist.

Kodi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve i miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, *“Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujës-jellës Kanalizimeve sh.a.”*”, përcakton kuadrin e marrëdhënies ndërmjet konsumatorëve dhe shoqërisë së ujës-jellës-kanalizimeve, duke rregulluar të drejtat dhe detyrimet e palëve, përfshirë çështjet që lidhen me furnizimin, matjen, tarifimin, kontratat dhe pagesat për shërbimin. Pretendimet që lidhen me mënyrën e llogaritjes së tarifës, vlefshmërinë e ngarkimit financiar, përgjegjësinë për amortizimin e matësit apo detyrimin e shoqërisë për të mbuluar koston e zëvendësimit, në mungesë të një lidhjeje të provuar me një shkak të mbrojtur nga LMD, mbeten çështje të natyrës kontraktore, administrative ose rregullatore të sektorit të ujës-jellës-kanalizimeve dhe nuk përbëjnë, në vetvete, objekt të shqyrtimit në kuptim të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

Komisioneri thekson se jo çdo pretendim për paligjshmëri, padrejtësi administrative apo moszbatim të një akti nënligjor përbën automatikisht diskriminim. Një sjellje diskriminuese është gjithmonë e paligjshme, por jo çdo sjellje e pretenduar si e paligjshme është domosdoshmërisht diskriminuese. Për t’u konsideruar e tillë, duhet të provohet ose të prezumohet në mënyrë të arsyeshme se trajtimi i kundërshtuar është i lidhur me një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe dokumentacionit të paraqitur nuk rezulton që ankuesi të ketë paraqitur informacion të mjaftueshëm për të krijuar prezumimin e diskriminimit për shkak të moshës. Pretendimi i tij përjashtimisht mbështetet në faktin se është pensionist dhe në bindjen se kjo cilësi duhet ta përjashtojë nga pagesa e zëvendësimit të matësit.

Megjithatë, ankesa nuk përmban të dhëna konkrete që të tregojnë trajtim më pak të favorshëm për shkak të moshës, krahasim me persona të tjerë në rrethana të ngjashme, apo lidhje shkakësore ndërmjet karakteristikës së mbrojtur dhe veprimit të kundërshtuar të Shoqërisë Ujës-jellës Kanalizime Fier sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “ç³”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, nuk mund të pranohet, pasi është haptazi e pabazuar dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

³ *“Ankesa nuk pranohet nëse: ...ç) është haptazi e pabazuar ose ”.*

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 32 dhe 33, pika 4, germa “ç”, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 161, datë 30.06.2026, paraqitur nga z. N.P, për arsye se nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)